



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dhe dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2020, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**P Ë R**  
**SHITJEN E AUTOMJETEVE, SI PRONË E LUAJTSHME E KOMUNËS**

**I.**

**MIRATOHET** Vendimi për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës së Prishtinës.

**II.**

Shpallja e ankandit publik, të cekur në pikën I të këtij vendimi, bëhet për automjetet të cilat janë në pronësi të Komunës.

**III.**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista e automjeteve me informatat përcjellëse për ankandin publik.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Departamenti i Prokurimit Publik.

**V.**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01-463/02-33142/20, më 10.02.2020

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Agim Kuleta